

## Aventurë në Azerbajjan: Zbulimi i Tokës së Zjarrit

### Cmimet :

**1220** Euro per person ne dhome teke

**1090** Euro per person ne dhome dyshe/matrimoniale/treshe

### Përshkrimi i shërbimit

Udhëtim në Azerbajjan

Dita 1, 18 Prill: Tiranë – Baku

Nisja nga Tirana në 13:30 dhe mbërritja në Baku. Takimi & asistenca në Aeroport me partnerët tanë, dhe transfertë në Baku. Akomodimi në Baku.

Dita 2, 19 Prill: Baku

Dita jonë nis me një mëngjes te bollshëm në Hotel. Pas mëngjesit do të fillojmë me vizitën e Kryeqytetit të Azerbajjanit, Baku. Turi fillon me vizitë në Highland Park. Një atraksion ku do të shijojmë një pamje te mrekullueshme të gjithë qytetit. Po ashtu të detit Kaspik dhe Flame Towers, te cilat janë të dukshme nga cdo pikë e qytetit.

Do të vazhdojmë vizitën tonë duke kaluar në qendrën mesjetare të qytetit e cila është nën ruajtjen e UNESCO-s. Një vend magjik, rrethuar nga mure te shek. 12-te, e mbushur me histori dhe arkitekturë lindore . Këtu do të shikojmë Maiden tower, vendi më misterioz i Bakut, pasi dhe në ditet e sotme, askush nuk e di përse është ndërtuar. Më tej i drejtohem Pallatit Shirvanashah, rezidenca e mbretërve te Azerbajjanit, që zë vend në pikën më të lartë të Citadelës. Qyteti i vogël brenda Citadelës është një labirint rrugicash të ngushta. Aty banojnë disa nga familjet më të vjetra të Azerbajxhanit dhe gjenden dyqane me punime artizanale tradicionale. Përfundojmë vizitën e qytetit të vjetër dhe i drejtohem shëtitorës buzë detit, e cila ofron një pamje te mrekullueshme te qytetit. Një ndalesë tek “Syri i Bakut” do të na mundësojë një shëtitje në kanalet e “Venecias së Vogël”.

Më tej vizitojmë Muzeun e Tapeteve dhe shëtisim në rrugën Nizami. Në këtë rrugë baronët e naftës kanë ndërtuar ndërtesa shumë të bukura ku mund të bëjmë shopping.

Darka në restorant, transfertë në hotel.

Dita 3, 20 Prill: Gabala

Mëngjesi në hotel dhe do të nisemi për një ekskursion në Gabala ( ora 10.00).

Ndalojmë në Ujëvarat Yeddi Gozel (7 Bukuritë), në fshatin Vandam të Gabalës. Emri “7 Bukuritë” vjen nga 7 rrugët pergjatë malit që të çojnë tek ujëvarat. Përgjatë rrugës mund të shijojmë një çaj nëpër shtëpitë e vogla te çajit shoqëruar me lloje te ndryshme receli. Më interesantja është në fund ku mund te shijojmë çajin me një pamje dhe tingull të mrekullueshëm në sfond. Do të vazhdojmë për tek Liqeni Nohur, i cili është një nga vendet më të bukura të Gabalës menjë pamje spektakolare të Maleve Kaukaz. Cdokush mrekullohet nga pamja madhështore e Liqenit Nohur ku qetësia dhe tingujt e cicërimave të zogjve ofrojnë një atmosferë tejet qetësuese.

Resorti Malor Tufandang është një resort i domosdoshëm për tu vizituar. I ndertuar si një gur i

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: info@etg.al

www.elitetravel.al

cmuar në kurorën e maleve përreth padyshim që ka një pamje mbresëlenëse. (Hyrja e përfshire) Darka në restorant dhe transferta në hotel në Gabala.

Dita 4, 21 Prill: Baku – Gobustan

Konsumojmë mengjesin dhe nisemi për në Baku, vizitojmë Gobustanin. Që nga arti parahistorik I shkëmbinjve deri në guret muzikorë, e kaluara parahistorike e popullit të Azerbajxhanit vjen e gjallë në Rezervatin e Gobustanit. Ai strehon një koleksion prej 600 petroglifeve të lashta me skena nga menyra e jetesës së popujve midis 5000 dhe 20 000 vjet më parë. I krijuar në vitin 1966, Reservati i Gobustanit ndodhet midis maleve Boyukdash, Kichikdash dhe Jingirdagh, rreth 60 km nga Baku. Përvec artit parahistorik të shkëmbinjve, mund të eksplorojmë mbetjet e Guvave, vendbanimeve dhe varrezave të perdorura nga njerëzit nga Periudha Paleolitike deri në Mesjetë.

Dy nga gjërat më të spikatura në këtë Rezervat janë:

1- Një mbishkrim i një ushtari Romak në shekullin I-rë, është mbishkrimi Romak më Lindor i gjetur deri sot.

2- Një gur muzikor 2 metër i gjatë I cili lëshon një tingull të ngjashëm me tamburinën kur goditet me një gur te vogël.

Në një distancë të shkurtër më tej do të kemi mundësinë të shohim një nga mrekullitë natyrore më intriguese, Vullkanet e Baltës.

Darka në Restorant dhe transferta në hotel në Baku.

Dita 5, 22 Prill : Absheron dhe Shopping

Dita nis me një mëngjes të bollshëm. Në orën 10.00 do të vizitojmë Tempullin e Zjarrit Ashtegah, në fshatin Surkhani i cili ka tërhequr turma vizitorësh aventurierë.

I ndërtuar gjatë shek. 17 – 18 , përreth flakëve që digjen në mënyrë natyrore, të cilat më parë adhuroheshin nga fiset Zoroastriane, ky vend u kthye në një pikë shumë të rëndësishme pelegrinazhi për adhuruesit e Zjarrit Hindu deri në vitet 1880. Sot është një muze shumë interesant që zakonisht shoqërohet me një udhëtim në Yanardag, “Mali që digjet” në fshatin Mammadli ku një mur flakësh 10 metra digjen ditë e natë rrëzë një kodre. Këto flakë natyrore janë përshkruar nga Marco Polo në shekullin e 13-të dhe vazhdojnë të bejnë kuriozë shumë vizitorë nga e gjithë bota dhe në ditët e sotme, për të cilat mund të mësoni gjithcka në kompleksin e Muzeut.

Pas kësaj vizite do të kthehemi në Baku dhe do të vazhdojmë me shopping.

Pjesa e Qytetit të vjetër ofron një sërë dyqanesh me gjëra antike dhe suvenire. Në rrugën Nizami do të gjeni të gjitha dyqanet dhe markat moderne.

Darka në restorant dhe kthimi në hotel.

Dita 6, 23 Prill: Baku – Tiranë

Herët në mëngjes do të bëhet transferta për në aeroport për të marrë fluturimin për Tiranë.

## **Detajet e Turit**

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

### **Përfshihen në çmim**

Fluturimi V/A Tiranë – Baku – Tiranë

5 netë Akomodim në Hotel 4\*

Mëngjeset dhe Darkat Transporti me autobus komod sipas itinerarit të përshkruar në program

Guidë Lokale në Anglisht

Shoqërues Shqiptar nga agjensia

Biletat e hyrjeve në monumente dhe muze sipas programit

### **NUK përfshihen në çmim Drekat**

Hyrjet që nuk përmenden në program Shpenzime personale

Gjithcka që nuk përmendet në rubriken “përfshihet“

### **Shumë e rëndësishme :**

- ◆ Klienti duhet të paraqitet 3 orë përpara fluturimit në aeroport
- ◆ Pasaporta duhet të jetë e padëmtuar dhe brenda afatit të vlefshmërisë (6 muaj)

### **Fluturimi**

Shqiperi – Azerbajjan 18 Prill 2024 LOT Airlines

TIA 13.30 – WAW 15.40

WAW 23.00 – GYD 05.10

Azerbajjan – Shqiperi 23 Prill 2024

GYD 06.10 – WAW 08.45

WAW 14.30 – TIA 16.40

Bagazhe 8 kg dore dhe 23 kg stive te perfshira

Politikat e Shërbimit

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

### **PA KOSTO TË FSHEHURA**

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

### **SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA**

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t’i ofruar mysafirëve tanë siguri “online”.

### **POLITIKAT E PRIVATËSISË**

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t’u

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: info@etg.al

www.elitetravel.al

sigurar që jemi duke ecur me hapin e kohës përsa i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

#### **SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT**

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë i Operacioneve do të jetë gati për t'ju asistuar.

#### **KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL**

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

#### **PAGESA PER REZERVIMIN**

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes

Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

#### **POLITIKAT E KANCELIMEVE**

Ne rast te anullimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte : 40 % nese anullimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anullimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes

100% nese anullimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjeter, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërin nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën [info@etg.al](mailto:info@etg.al) për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.